



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 6358/ prot.

Tiranë, më 08.11.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1247, datë 13.10.2008.

SHOQËRISË “SEASIF GROUP” SH.P.K

Rruga “Brigada VIII –të”, Pallati “Teknoprojekt”, Nr.1, Apartamenti 8/5, Tiranë.

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Seasif Group” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1247, datë 13.10.2008, për mineral argjilë, në objektin “Melgushë”, Shkodër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresat nr.1132 prot., datë 30.01.2018 e nr.4104 prot., datë 16.04.2018, protokolluar respektivisht në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.1998 prot., datë 31.01.2018 e nr. 6358 prot., datë 17.04.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1247, datë 13.10.2008, për mineral argjilë, në objektin “Melgushë”, Shkodër, për arsye se nuk është paguar garancia financiare e rehabilitimit të mjedisit për vitin 2017-2018, siç është përcaktuar në nenin 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjithashtu nuk keni miratuar programin vjetor, siç përcaktohet në germën “ç”, të nenit 25, të ligjit që cituam më lart.

Leja minerare nr.1247, datë 13.10.2008, që ju zotëroni, ka pasur afat vlefshmërie 10 vite i cili përfundon më datë 13.10.2018.

Kjo leje është dhënë në përputhje me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Sipas pikës nr.6, të nenit 24, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të kishit aplikuar 180 ditë përpara përfundimit të afatit 10 vjeçar, pranë QKB –së, për të zgjatur afatin edhe 10 vite të tjera, gjë të cilën ju nuk e keni bërë.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1247, datë 13.10.2008, për mineral argjilë, në objektin “Melgushë”, Shkodër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1247, datë 13.10.2008, për mineral argjilë, në objektin “Melgushë”, Shkodër.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

